

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                   |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Hitleri vrau mbesën e tij? Zbulimi i rrallë prej gati 1 shekulli: Ishte i dashuruar me të/ Dokumentet tronditëse                                  |
| ADRESA  | https://boldnews.al/2026/09/25/hitleri-vrau-mbesen-e-tij-zbulimi-i-rralle-prej-gati-1-sh<br>ekulli-ishte-i-dashuruar-me-te-dokumentet-tronditese/ |
| BURIMI  | boldnews.al                                                                                                                                       |
| GJENDJA | online                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 19:40:55 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 19:35:53 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | c10b43ccbe198373024851f7e3077d443ea1bc1f6eeaf40e6df4c51f9311d4e5 |
| TEKSTI     | 0522259924d1ecbcb3153fc6ed1c8b7af7d13088740ffdf69a5b794d8915fc22 |
| PAMJA      | 72a15bbefbee818e5a27ece03add2202b1688b6f5cdb2346b0e4920880ddc654 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 34142aca9f7081d930af3d72b73b323f0587d43f3d303040ec6f9bfc21225cf9                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/34142aca9f7081d930af3d72b73b323f0587d43f3d303040ec6f9bfc21225cf9

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Fillimi &gt; BOTA

# Hitleri vrau mbesën e tij? Zbulimi i rrallë prej gati 1 shekulli: Ishte i dashuruar me të/ Dokumentet tronditëse

21:35 : 25/09/2026 në BOTA



Një sërë dokumentesh arkivore të zbuluara herë pas here ngre dyshime të forta që Adolf Hitleri mund të ketë vrarë mbesën e tij, e cila u gjet e vdekur në apartamentin e diktatorit në Mynih, në vitin 1931, ngjarje që u cilësua zyrtarisht si vetëvrasje.

Angela 'Geli' Raubal, 23 vjeçe, u gjet e vdekur me një plagë arme zjarri në gjoks, ndërsa arma ishte një pistoletë që i përkiste Hitlerit.

Dokumentet zyrtare tregojnë se Hitleri – i cili po fitonte famë, por ende nuk e kishte marrë pushtetin në Gjermani – ishte larguar nga Mynihu për në Nuremberg një ditë para vdekjes së mbesës, një afat kohor që do të vërtetonte se ai nuk mund të kishte qenë i përfshirë në vdekjen e saj.

Por historiani gjerman, Harold Sandner, thotë se ka zbuluar një detaj në regjistrin zyrtar të vdekjeve të Mynihut që jep datën dhe orën e zbulimit të trupit të Raubal, dhe që është pikërisht ora 10:15 e mëngjesit më 18 shtator 1931. Dy njoftime vdekjeje të gjetura në arkiva gjithashtu e mbanin atë datë. Nëse këto të dhëna janë autentike, ato do ta vendosnin vdekjen e Raubal rreth 24 orë më herët se sa besohet më parë, çka tregon se Hitleri ka qenë në Mynih kur u zbulua trupi i pajetë i të resë, shkruan CNN. Të dhënat zyrtare tregojnë se ai nuk u nis për në Nuremberg deri pasditen e 18 shtatorit.

Sipas **historianit** Sandner, të dhënat kontradiktore tregojnë për një mbulim të mundshëm të vrasjes nga zyrtarë të policisë, mbështetës të Partisë Naziste të Hitlerit. Gjetjet e historianit u botuan për herë të parë nga revista gjermane e lajmeve Der Spiegel dhe do të detajohen në librin e tij të ardhshëm, "Vdekja e Angela 'Geli' Raubal: Vetëvrasje apo lojë e ndyrë?", që pritet të publikohet muajin e ardhshëm.

Lexo edhe:

"Mbështetësit e Hitlerit nuk ishin të gjithë kriminelë", AfD rikthen dy politikanët e përjashtuar për komentet pro nazistëve

Katër gjermanë të arrestuar për festimin e ditëlindjes së Hitlerit

Thomas Weber: një ekspert mbi Gjermaninë naziste, dhe që e nihte prai shumë viteve

## TË GJITHA



**Hitleri vrau mbesën e tij?**  
Zbulimi i rrallë prej gati 1 shekulli: Ishte i dashuruar me të/ Dokumentet tronditëse

21:35 : 25/09/2026



**Plagjiatura godet sërish PS/**  
Doktoratura e Taulant Ballës nën akuzë, kapitulli 5 i kopjuar

21:30 : 25/09/2026



**Zbuloi se dikush tjetër kishte marrë identitetin e tij, drama e emigrantit nga Fieri**

21:22 : 25/09/2026



**Vdes një nga të plagosurit në atentatin ndaj Trumpit gjatë fushatës në Pensilvani**

21:19 : 25/09/2026



**Konflikt në Pazarin e Vjetër në Korçë, një i lënduar**

21:07 : 25/09/2026



**Protestuesit sfidojnë shiun, marshojnë nëpër Tiranë: Përi nuk ka Shqipëri**

20:49 : 25/09/2026



**Megaskandali me fondet e investimeve në Turqi, nën hetim 76 persona, 45 në pranga**

20:41 : 25/09/2026

Thomas Hirsch, një shqiptar me gjermaninë kombëtare, dhe që është prej shumë vitesh në CNN, i tha CNN se historiani është “jashtëzakonisht i përpiktë” dhe se dokumentet e tij janë të besueshme.

Shumë historianë besojnë se Hitleri ishte i dashuruar me Raubal dhe se sjellja e tij ndaj saj ishte bërë intensivisht kontrolluese dhe posesive. Pak para vdekjes së saj, Hitleri dhe Raubal besohet se kanë debatuar për dëshirën e saj për t'u larguar nga Mynihu për në Vjenë, për të ndjekur studimet muzikore. Të dhënat e zbuluara rishtazi nuk e zgjidhin misterin se si vdiq Raubal.

Megjithatë, ato rihapin pyetje që kanë vazhduar për gati 100 vjet rreth asaj që ndodhi saktësisht brenda shtëpisë së tij në Mynih ditën e vdekjes së saj.

Etiketa: Hitleri

Lajme të lidhura



**"Mbështetësit e Hitlerit nuk ishin të gjithë kriminelë", AfD rikthen dy politikanët e përjashtuar për komentet pro nazistëve**

22:45 : 25/02/2025



**Katër gjermanë të arrestuar për festimin e ditëlindjes së Hitlerit**

19:39 : 22/04/2024



**Erdogan akuza Izraelit: Ka tejkaluar mizoritë e Hitlerit**

20:10 : 18/04/2024



**Del libri/ Trump thoshte se Hitleri ka bërë edhe gjëra të mira**

22:48 : 11/03/2024



**Ç'do të ndodhte në Itali sikur një qytetar të manifestonte me portretet e Musolinit?**

15:42 : 29/11/2023



**Austri, shtëpia ku ka lindur Hitleri kthehet në një stacion policie**

20:52 : 21/08/2023



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.  
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

